

KPA lë në fuqi shkarkimin e ish-prokurori Artan Bajrami

Prokurori Artan Bajrami u shkarkua nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit pasi u akuzua për deklaram të rremë për blerjen e një apartamenti dhe mosdeklarim të dhuratave nga baxhanaku biznesmen.

Autor: [Edmond Hoxhaj](#) | BIRN | Tiranë



Prokurori Artan Bajrami. Foto: BIRN

Kolegji i Posaçëm i Apelit, KPA vendosi të premtën të lërë në fuqi vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, KPK për shkarkimin nga detyra të ish-drejtesit të ish-Prokurorisë së Apelit për Krimet e Rënda, Artan Bajrami.

Në njoftimin e KPA thuhet se trupi gjykues i Kolegjit, i përbërë nga Rezarta Schuetz kryesuese, Ardian Hajdari relator dhe Ina Rama, Luan Daci e Sokol Çomo anëtarë, shqyrtoi në dhomë këshillimi ankimin e prokurorit Bajrami kundër shkarkimit dhe vendosi lënien në fuqi të vendimit të KPK të dhënë më 14 shkurt 2019.

Prokurori Artan Bajrami u shkarkua nga detyra pas një karriere 35-vjeçare për shkak të deklaramit të rremë dhe të pasaktë të burimeve për blerjen e një apartamenti në Tiranë si dhe mosdeklarimin e dhurimeve prej 2.2 milionë lekësh në total nga baxhanaku i tij biznesmen.

Procesi i rivlerësimit për Bajramin në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit u krye nga trupi gjykues i drejtuar nga Valbona Sanxhaktari, me relatore Suela Zhegun dhe anëtare Brunilda Bekteshin.



RRETH AUTORIT

Edmond Hoxhaj

Edmond Hoxhaj është gazetar i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri. Ai ka punuar më herët për gazetën “Shqip”. Ai ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi. Hoxhaj ka punuar që nga viti 2001 në disa media të shkruara, ku ka mbuluar çështjet e aktualitetit dhe të drejtësisë.